



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa: Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax: ++381(0)38 229 838, e-mail: bspk@etuc.org



### **Komunikatë për medie**

**Prishtinë, 21 mars 2011** - Delegacioni i BSPK-së i kryesuar nga kryetari Haxhi Arifi, me 18 mars 2011, takuan Presidentin e Republikës së Kosovës, Behxhet Pacollin. Kryetari Arifi, foli për gjendjen e krijuar pas premtimeve për rritjen e pagave të punëtorëve, dhe njëherit njoftoi Presidentin për organizimin e BSPK-së dhe përgjithësisht për gjendjen ekonomike në vend. U diskutua për nevojën e ngritjes së pagave, që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e punëtorëve, por biseduan edhe për gjendjen jo të lehtë ekonomike, në të cilën po kalon vendi, e sidomos për nevojat e mëdha për investime kapitale dhe për vështirësitë e mbulimit të këtyre investimeve. Presidenti Pacolli, e vlerësoi lart punën dhe kontributin e BSPK-së, si një zëdhënëse dhe përfaqësuese e interesave të punëtorëve të Kosovës.

**Zyra për Informim, BSPK  
Fatma Rastelica**